**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2431/4prot. Datë 09.12.2022

# V E N D I M

**Nr. 1217/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Anila Malaj | Anëtar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 09.12.2022 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt**: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "AVDULI" SHPK në procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur e thjeshtuar" me Nr. REF-44556-10-05-2022, me objekt "Termoizolimi dhe përmirësimi i sistemit të ngrohjes i Konviktit Përmet" me fond limit 11 507 560 (njëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH., zhvilluar në datën 17.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Përmet

**Ankimues:** "AVDULI" SHPK
Lagjja 10 Korriku, Rruga Perlat Rexhepi, Objekt 3-katësh nr.4, Kati 1, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Përmet
Sheshi "Abdyl Frashëri" Përmet

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin

*e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*".

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06.10.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit "Procedurë e hapur e thjeshtuar" me Nr. REF-44556-10-05-2022, me objekt "Termoizolimi dhe përmirësimi i sistemit të ngrohjes i Konviktit Përmet" me fond limit 11 507 560 (njëmbëdhjetë milion e peseqind e shtatë mijë e peseqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH., zhvilluar në datën 17.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Përmet

II.2. Në datën 17.10.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 27.10.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| - "Aida Construction" | 9 449 304 | I skualifikuar |
| - "Avduli" ShPK | 9 952 709.6 | I skualifikuar |
| - "Eurostil" | 10 685 771 | I kualifikuar |

-
- “Zeqillari”SHPK 10 722 517 I kualifikuar
- “Asi 2Aco” 10 825 655 I skualifikuar
- “Tea-D” 11 473 171 I skualifikuar

II.4. Në datën 27.10.2022 operatori ekonomik “AVDULI” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:
*Ka mospërputhje në vlerën me TVSH midis shtojcës nr. 1 Formular Oferte me shtojcën nr.2 Lista e Çmimeve sipas zërave të preventivit.*
*- Mungon në SPE dokumentacioni Kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë, librezë pune e kërkuar për drejtuesin teknik inxhinier ndërtimi Z.Inid Murati në pikën 2.3.4. - Mungon në SPE dokumentacioni Kontratë pune të vlefshme, diplomë, liçense për ushtrimin individual të profesionit e kërkuar për 1 (një) mjek të përgjithshëm në pikën 2.3.8. - Në shtojcën 8 të formularit të vetedeklarimit shkronja C “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” në tabelen e mjeteve dhe paisjeve në pronësi ose qera ka paqartësi në raport me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit në pikën 2.3.10 dhe vetedeklarimit si më poshtë: a) Në tabelen e deklaratës së pikës C pika 4 të formularit të vetedeklarimit janë deklaruar paisjet: Doreza për punëtorë – Faturë nr.462 datë 16.02.2021 , Kokore mbrojtëse për kokën – Faturë Nr. 36 datë 25.03.2019, Karroca dore – Faturë Nr.29 datë 24.08.2011, Jeleke fosforeshentë për punëtorët – Faturë Nr.1503 datë 11.09.2021, Skeleri – Faturë Nr. 79 datë 25.03.2004. Ky OE nuk ka përcaktuar sasitë për këto pajisje. Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Dokumentacioni ligjor dhe teknik nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në DST duke e cilësuar si ofertë të pavlefshme.*

II.5. Në datën 31.10.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e **Njoftim-Fituesi** në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.6. Në datën 07.11.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2022/2655 dhe me nr. 2431/2022 protokolli e operatorit ekonomik “AVDULI” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesave, i publikoi ato në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të

procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2431/2 prot datë 07.11.2022 me arsyet e skualifikimit të ankimuesit në procedurën objekt shqyrtimi.

II.8. Me shkresën nr. 3384/1 prot, datë 11.11.2022, protokolluar me tonën me nr. 2431/3 prot datë 14.11.2022, (shkresa nr. 3386/1prot. Datë 11.11.2022), autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, duke dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues "Avduli" ShPK dhe ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke njoftuar operatorin ekonomik dhe duke vënë në dijeni Komisioni i Prokurimit Publik.

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

**III**

**Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor

**Arsyeton**

III.1. Lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues "Avduli" SHPK, me argumentat se: "*Ka mospërputhje në vlerën me TVSH midis shtojcës nr. 1 Formular Oferte me shtojcën nr.2 Lista e Çmimeve sipas zërave të preventivit.",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, "*Udhëzime për operatorët ekonomikë*", Seksioni 1 "*Hartimi i ofertës*" pika 4. përcaktohet se: "*Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar*".

III.1.2. Në dokumentet e tenderit, "*Udhëzime për operatorët ekonomikë*", Seksioni 1 "*Hartimi i ofertës*" pika 6. përcaktohet se:

1. *Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit.*

2. *Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar zërat e punimeve që do të realizohen, sasitë dhe çmimin e tyre në rastin kur në kohën e ofertimit është e mundur (ka një projekt-preventiv mbi bazën e të cilit të do realizohen punimet).*

   *Kur autoriteti/enti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventiv por ka vetëm një projektide apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron, kontraktori paraqet vetëm ofertë ekonomike totale, në pamundësi për të paraqitur zërat e punimeve që do të realizohen, sasitë apo çmimet e tyre.*

3. *Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.*

4. ***Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.***

   *Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.*

III.1.3. Në dokumentet e tenderit, në Seksionin 2 "Lista e shtojcave", autoriteti kontraktor ka përcaktuar shtojcat të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre dokumenteve si më poshtë:

*Shtojca 1. Formulari i Ofertës*
*Shtojca 2. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit*
*Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës*
*Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial*
*Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike*
*Shtojca 6. Grafiku i realizimit të punimeve*
*Shtojca 7: Formularët e Përshtatshmërisë dhe Kualifikimit të Ofertuesve*
*Shtojca 8: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*
*Shtojca 9: Formulari i Vlerësimit*
*Shtojca 10: Preventivat e Punimeve*
*Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.*

*Shtojca 12 - Formulari i Njoftimit të Fituesit*
*Shtojca 13 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit) .*
*Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër*
*Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)*

III.1.4. Në shtojcën 1 "*Formulari Ofertës*" pjesë e dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

*Shtojca 1.*

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

*FORMULARI I OFERTËS*

*Data:*
*Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:*
*Për: [Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]*
*Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]*
*Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:*

**(a)** *Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.*

**(b)** *Ne [vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti), nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit].*

**(c)** *Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për [vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e*

*referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.*

(d) *Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:*

1. *Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;*
2. *Njoftimin e Kontrates;*
3. *Kriteret e Vlerësimit;*
4. *Kriteret e Përzgjedhjes;*
5. *Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;*
6. *Preventivin e çmimeve*
7. *Termat e referencës (nëse është rasti)*
8. *Detyrën e projektimit (nëse është rasti)*
9. *Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;*
10. *Kushtet e Veçanta të Kontratës.*

**(e)** *Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: ------------ [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];*

**(f)** *Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ------------ [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]*

| | |
|---|---|
| *Emri i përfaqësuesit të ofertuesit* | |
| *Nënshkrimi* | |
| *Vula* | |

III.1.5. Në shtojcën 2 "*Lista e Çmimeve sipas Zërave të Preventivit*" pjesë e dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

| |
|---|
| *Shtojca 2.*<br>*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*<br>*LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT* |

*Data:* ________________________________

*Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:*
___________________________________

*Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):* ________________________________________________

*Monedha:* ___________

*Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.*

*Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.*

*Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.*

*Oferta ekonomike e detajuar*

| *Nr* | *Nr. Analizë* | *Përshkrimi i Punëve* | *Njësi* | *Sasia* | *Çmimi/ Njësi* | *Cmimi total* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *1.* | | | | | | |
| *2.* | | | | | | |
| *3.* | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| *Shuma* | | | | | | |
| *Fondi Rezervë* | | | | | | |
| *Shuma* | | | | | | |
| *TVSH* | | | | | | |
| *SHUMA TOTAL* | | | | | | |

*Nënshkrimi i ofertuesit* _________________________
*Vula*
*Shënim:Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____( e kërkuar në dokumentat e tenderit )*

III.1.6. Në preventivin pa çmime pjesë e dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

# PREVENTIV - PUNIMESH

OBJEKTI: TERMOIZOLIMI DHE PERMIRESIMI I SISTEMIT TE NGROHJES I KONVIKTIT PERMET

INVESTITOR: BASHKIA PERMET

Adresa: Lagje Mejden, Permet

| Nr | Nr.Anlz | Pershkrimi punimeve | Njesia | Sasia | Çmimi | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| a | b | c | d | e | f | g |
| | | | | | | |
| **I** | ***Punime prishje*** | | | | | |
| 1 | An | Prishje suva e jashtme | m2 | 70.00 | | |
| 2 | 2.37/5a | Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km | m3 | 35.00 | | |
| 3 | An | Prishje suva brenda | m2 | 80.00 | | |
| 4 | An | Prishje plintuese pllaka gres | ml | 50.00 | | |
| 5 | An | Prishje dritare duralumini | m2 | 10.62 | | |
| 6 | An | Prishje dyer duralumini | m2 | 7.30 | | |
| 7 | An | Heqje dere tamburato | m2 | 1.80 | | |
| | | **Shuma - I** | | | | **0** |
| | | | | | | |
| **II** | ***Punime ,termoizolimi,suvatimi,shtresash etj*** | | | | | |
| 1 | An | Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete | m2 | 851.00 | | |
| 2 | 2.308/a | Suvatim me grafiato h > 4 m | m2 | 1,085.00 | | |
| 3 | 2.308/a | Suvatim strehe me grafiato M-25 | $m^2$ | 12.50 | | |
| 4 | 2.404/1 | Boje hidroplastike importi cilesi e I-re (fasada e objektit) | m2 | 1,097.50 | | |
| | | RIPARIME | | | | |
| 5 | 2.331 | Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m | m2 | 70.00 | | |
| 6 | 2.273/4 | Shtrese me pllaka mermeri (per prigjet e dritareve) | m2 | 20.00 | | |
| 7 | 2.328 | Patinim muri allçi (stuko) | m2 | 50.00 | | |
| 8 | 2.330 | Patinim tavani allçi (stuko) | m2 | 30.00 | | |
| 9 | 2.300 | Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah | m2 | 30.00 | | |
| 10 | 2.310 | Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25 | m2 | 50.00 | | |
| 11 | 2.324b | Plintuse grez h = 10 cm | ml | 50.00 | | |
| 12 | 2.375/1 | F V dritare d/alumini me dopio xham (kopshti+kuzhina) | m2 | 10.62 | | |
| 13 | 2.395/1 | F V dyer d/alumini me dopio xham | m2 | 7.30 | | |
| 14 | 2.388/1 | V F dyer te brendeshme tamburate te rimesuara | m2 | 1.80 | | |
| | | **Shuma - II** | | | | **0** |
| **III** | ***Punime hidroizolimi,tarace,lyerje+ etj*** | | | | | |
| 1 | 2.404/1 | Boje hidroplastike importi cilesi e I-re (muri rrethues) | m2 | 250.00 | | |
| 2 | 2.404/1 | Boje hidroplastike importi cilesi e I-re (ambjenti brenda) | m2 | 200.00 | | |
| 3 | 2.401 | Boje vaji siperfaqe metalik ( kangjellat e jashtme) | m2 | 299.00 | | |
| 4 | 2.239/a | Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm (soleta) | m2 | 520.00 | | |
| 5 | 2.197 | Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama | m2 | 700.00 | | |
| 6 | 2.423/a | Shtrese avullizoluese gjeotekstil | m2 | 700.00 | | |
| 7 | 2.264 | Shtrese lluster cimento 1:2 | m² | 565.00 | | |
| 8 | 3.29 | Zgare hekuri 20x20cm ϴ5 (per armim batuto) | ton | 1.00 | | |
| 9 | 2.266 | Shtrese me pllaka granili te zakonshme 30x30 cm | m2 | 710.00 | | |
| 10 | 2.203 | Veshje korrnize llamarine xingat ne kornizen e tarraces t=50 cm | ml | 145.00 | | |
| 11 | 2.407 | Kapak beton arme te parapregatitur per oxhaket | m² | 6.00 | | |
| | | **Shuma - III** | | | | **0** |
| | | | | | | |
| **IV** | ***Sistemi I mbrojtjes nga shkarkimet Atmosferike dhe tokezimi*** | | | | | |
| 1 | 2.a-74 | Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=2.0m | cope | 10.00 | | |
| 2 | 2.a-97 | Percjelles tokezimi bakri , Cu, S=50mm2 i zhveshur | ml | 145.00 | | |
| 3 | An | Fv.Zbare ekuipotenciale per lidhje percjellesi | cope | 2.00 | | |
| 4 | An | F.V Morseta bashkuese T-I & kryq universale | cope | 20.00 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | An | F.v kuti shpernarese 100 x100 IP 40 | cope | 3.00 | | |
| 6 | An | F.V Shkeputes per matje komplet & kuti PT-5:IP-65 me shenje toke. | cope | 1.00 | | |
| 7 | 2.a-98 | Percjelles shirit zinku tokezimi, Zn= 30x3mm | ml | 145.00 | | |
| 8 | An | F.V Morseta suporte me zbritje me bulon kapje e mberthimi per Zn | cope | 50.00 | | |
| 9 | An | F.v Shtiza me maje te zinkuara d=16 mm,L=0.5 ml | cope | 8.00 | | |
| 10 | An | F.V Kubike te gatshem betoni 40x40x40 | cope | 35.00 | | |
| | | **Shuma - IV** | | | | **0** |
| | | | | | | |
| **V** | ***Punime per MNZ*** | | | | | |
| 1 | an | F.V. Fikse zjarri me pluhur ,destinacioni per mbrojtje nga zjarri,kapaciteti 6 kg | cope | 4.00 | | |
| 2 | an | F.V. Fikse zjarri me CO2 ,destinacioni per mbrojtje e pajisjeve elektrike nga zjarri,kapaciteti 6 kg | cope | 2.00 | | |
| 3 | an | Fv.Tabela Sinjalistike - Fikse zjarri me pluhur | cope | 4.00 | | |
| 4 | an | Fv.Tabela Sinjalistike - Fikse zjarri me CO2 | cope | 2.00 | | |
| 5 | an | F.v Tabela orientuese hyrje/dalje | cope | 6.00 | | |
| 6 | an | F.V. Dedektor tymi/temperature zjarri | cope | 57.00 | | |
| 7 | 2. a-139 | Ndricues evakuimi me llampe 1x11w,IP40 | cope | 6.00 | | |
| 8 | an | F.V Kutia e ndihmes se shpejte | cope | 1.00 | | |
| | | **Shuma - V** | | | | **0** |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| **VI** | ***Punime ngrohje*** | | | | | |
| 1 | an | Cmontim/montim kaldaje me te gjitha rakorderite perkatese | cope | 1.00 | | |
| 2 | an | Cmontim/montim radiatore | cope | 45.00 | | |
| 3 | 2.534 | Termoizolim tubo pambuk mineral, material termoizolues,rrjete, azbest, etj. | m2 | 14.10 | | |
| 4 | an | F.V Oxhak çeliku inoks/baker me dopio paret, me shtrese izioluese ne mes 300/350 mm,pajisur me te gjithe aksesoret | komplet | 1.00 | | |
| 5 | 2.494/2 | F.V saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm | cope | 4.00 | | |
| 6 | An | F.V Ajernxjerres Ø ½" | cope | 45.00 | | |
| 7 | An | F.V Elemente fiksues ne mur | cope | 90.00 | | |
| 8 | An | F.V Tub Cu te perkulshem me termoizolim Ø 14 x 1.0 mm, UNI EN 1057 | ml | 45.00 | | |
| 9 | **2.482/1** | F.V Kabell transmetimi ( 2 x 1.5 ) mm² | ml | 50.00 | | |
| 10 | An | F.V Rregullator klimatik elektroinik me mikroprocesor | cope | 1.00 | | |
| 11 | An | F.V Grupi I mbushjes automatike | komplet | 1.00 | | |
| 12 | 2.494/6 | F.V saracineska bronzi Ø63 | cope | 2.00 | | |
| 13 | An | F.V Kolektor shpemdares per radiatoret Ø1" (9+9)x1/2" I kompletuar me valvula nderprerese ne hyrje-dalje, valvul balancuese, valvul zonale dy kalimshe, ajernxjerrese, valvula shkarkim, kuti montimi, dhe element te nevojshem montimi. | komplet | 2.0 | | |
| | | **Shuma - VI** | | | | **0** |
| | | | | | | |
| | | **SHUMA - I + II + III + IV+V+VI** | | | | **0** |
| | | ***TVSH 20 %*** | | | | **0** |
| **VII** | ***Paisje per ngrohje*** | | | | | |
| 1 | An | F. Element radiatori alumini per klasat , Presioni max. 600 kPa, interaksi 600 x 100 mm, ΔTek = 50°C, Fuqia Termike 212 W. | cope | 360.00 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Analize | F.V Kaldaje çeliku (grup termik), lenda e djegeshme ashkla druri - capaciteti Q=120-150 kW =- lidhjet DN 40-80 - dalja e oxhakut Ø 300-350 mm. me pompe antikondense te inkorporuar, e pajisur me te gjithe komponentet e sigurise dhe kontrollit si dhe aksesoret e nevojshem.<br>Karakteristikat Teknike:<br>-Fuqia termike 120-150 Kw<br>-Dimensionet e tubave dergim kthim :2 1/2".<br>-Diametri i oxhakut te tymit Ø300-350 | cope | 1.0 | | |
| 3 | An | F.V Termometer ( 0÷120°) | cope | 2.00 | | |
| 4 | An | F.V Manometer | cope | 2.00 | | |
| 5 | An | F.V Presostat sigurie | cope | 1.00 | | |
| 6 | An | F.V Flusostat | cope | 1.00 | | |
| 7 | An | F.V Sensor temperature | cope | 2.00 | | |
| 8 | An | F.V Sensor i temperatures se ambientit te jashtem | cope | 1.00 | | |
| 9 | An | F.V Pompe teke e kaldajes (Inverter) - prurja 20 m3/h; - prevalenca 50 kPa; - lidhjet DN 80, Pn 10; - fuqia elektrike 0.75 kW , rryma 2.9 A; - ushqimi 3F/230V/50Hz. | cope | 1.0 | | |
| 10 | An | F.V Ene zgjerimi me diafragme per linjat e terminaleve ngrohes: Volumi 50lit, Diametri 407 mm, Lartesia 530 mm, P.max 4 bar, T.punes -10÷99°C, Lidhja Ø3/4" | cope | 2.0 | | |
| | | | | | | |
| **Shuma - VII** | | | | | | **0** |
| | | | | | | |
| **SHUMA PER ZBATIM (I-VII)** | | | | | | **0** |

***V.O. Ky Preventin u hartua ne baze te:*** Vendim Nr. 629, Datë 15.7.2015 Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre

III.1.7. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP konstaton, se në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik "Avduli" SHPK ka dorëzuar:

- Shtojcën 1 "Formularin e Ofertës" në të cilën është pasqyruar deklarimi se

  i. Vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH është 9,952,709.6
  ii. Vlera totale e ofertës ekonomike me TVSH është 11,943,251.5

**Shtojca 2.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT**

**Data: 17.10.2022**

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: REF-44556-10-05-2022**

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): AVDULI sh.p.k- J66703306O,**

**Monedha: LEK**

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Oferta ekonomike e detajuar**

PREVENTIV - PUNIMESH

| Nr | Nr.Anlz | Pe rshkrimi punimeve | Njesia | Sasia | Çmimi | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| a | b | c | d | e | f | g |
| | | | | | | |
| I | *Punime prishje* | | | | | |
| 1 | An | Prishje suva e jashtme | m2 | 70.00 | 200.00 | 14,000.00 |
| 2 | 2.37/5a | Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km | m3 | 35.00 | 500.00 | 17,500.00 |
| 3 | An | Prishje suva brenda | m2 | 80.00 | 180.00 | 14,400.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | An | Prishje plintuese pllaka gres | ml | 50.00 | 80.00 | 4,000.00 |
| 5 | An | Prishje dritare duralumini | m2 | 10.62 | 180.00 | 1,911.60 |
| 6 | An | Prishje dyer duralumini | m2 | 7.30 | 150.00 | 1,095.00 |
| 7 | An | Heqje dere tamburato | m2 | 1.80 | 180.00 | 324.00 |
| | | **Shuma - I** | | | | **53,230.60** |
| | | | | | | |
| **II** | ***Punime ,termoizolimi,suvatimi,shtresash etj*** | | | | | |
| 1 | An | Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete | m2 | 851.00 | 2,200.00 | 1,872,200.00 |
| 2 | 2.308/a | Suvatim me grafiato h > 4 m | m2 | 1,085.00 | 950.00 | 1,030,750.00 |
| 3 | 2.308/a | Suvatim strehe me grafiato M-25 | m2 | 12.50 | 1,100.00 | 13,750.00 |
| 4 | 2.404/1 | Boje hidroplastike importi cilesi e I-re (fasada e objektit) | m2 | 1,097.50 | 150.00 | 164,625.00 |
| | | RIPARIME | | | | |
| 5 | 2.331 | Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m | m2 | 70.00 | 600.00 | 42,000.00 |
| 6 | 2.273/4 | Shtrese me pllaka mermeri (per prigjet e dritareve) | m2 | 20.00 | 5,300.00 | 106,000.00 |
| 7 | 2.328 | Patinim muri allçi (stuko) | m2 | 50.00 | 350.00 | 17,500.00 |
| 8 | 2.330 | Patinim tavani allçi (stuko) | m2 | 30.00 | 400.00 | 12,000.00 |
| 9 | 2.300 | Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah | m2 | 30.00 | 700.00 | 21,000.00 |
| 10 | 2.310 | Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25 | m2 | 50.00 | 600.00 | 30,000.00 |
| 11 | 2.324b | Plintuse grez h = 10 cm | ml | 50.00 | 180.00 | 9,000.00 |
| 12 | 2.375/1 | F V dritare d/alumini me dopio xham | m2 | 10.62 | 10,200.00 | 108,324.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | (kopshti+kuzhina) | | | | |
| 13 | 2.395/1 | F V dyer d/alumini me dopio xham | m2 | 7.30 | 12,000.00 | 87,600.00 |
| 14 | 2.388/1 | V F dyer te brendeshme tamburate te rimesuara | m2 | 1.80 | 10,000.00 | 18,000.00 |
| | | **Shuma - II** | | | | **3,532,749.00** |
| **III** | ***Punime hidroizolimi,tarace,lyerje+ etj*** | | | | | |
| 1 | 2.404/1 | Boje hidroplastike importi cilesi e I-re (muri rrethues) | m2 | 250.00 | 150.00 | 37,500.00 |
| 2 | 2.404/1 | Boje hidroplastike importi cilesi e I-re (ambjenti brenda) | m2 | 200.00 | 150.00 | 30,000.00 |
| 3 | 2.401 | Boje vaji siperfaqe metalik ( kangjellat e jashtme) | m2 | 299.00 | 400.00 | 119,600.00 |
| 4 | 2.239/a | Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm (soleta) | m2 | 520.00 | 400.00 | 208,000.00 |
| 5 | 2.197 | Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama | m2 | 700.00 | 950.00 | 665,000.00 |
| 6 | 2.423/a | Shtrese avullizoluese gjeotekstil | m2 | 700.00 | 200.00 | 140,000.00 |
| 7 | 2.264 | Shtrese lluster cimento 1:2 | m² | 565.00 | 350.00 | 197,750.00 |
| 8 | 3.29 | Zgare hekuri 20x20cm ϴ5 (per armim batuto) | ton | 1.00 | 125,000.00 | 125,000.00 |
| 9 | 2.266 | Shtrese me pllaka granili te zakonshme 30x30 cm | m2 | 710.00 | 1,000.00 | 710,000.00 |
| 10 | 2.203 | Veshje korrnize llamarine xingat ne kornizen e tarraces t=50 cm | ml | 145.00 | 1,100.00 | 159,500.00 |
| 11 | 2.407 | Kapak beton arme te parapregatitur per oxhaket | m² | 6.00 | 1,200.00 | 7,200.00 |
| | | **Shuma - III** | | | | **2,399,550.00** |
| | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| **IV** | ***Sistemi I mbrojtjes nga shkarkimet Atmosferike dhe tokezimi*** | | | | | |
| 1 | 2.a-74 | Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=2.0m | cope | 10.00 | 1,100.00 | 11,000.00 |
| 2 | 2.a-97 | Percjelles tokezimi bakri , Cu, S=50mm2 i zhveshur | ml | 145.00 | 450.00 | 65,250.00 |
| 3 | An | Fv.Zbare ekuipotenciale per lidhje percjellesi | cope | 2.00 | 900.00 | 1,800.00 |
| 4 | An | F.V Morseta bashkuese T-I & kryq universale | cope | 20.00 | 530.00 | 10,600.00 |
| 5 | An | F.v kuti shpernarese 100 x100 IP 40 | cope | 3.00 | 150.00 | 450.00 |
| 6 | An | F.V Shkeputes per matje komplet & kuti PT-5:IP-65 me shenje toke. | cope | 1.00 | 1,800.00 | 1,800.00 |
| 7 | 2.a-98 | Percjelles shirit zinku tokezimi, Zn= 30x3mm | ml | 145.00 | 280.00 | 40,600.00 |
| 8 | An | F.V Morseta suporte me zbritje me bulon kapje e mberthimi per Zn | cope | 50.00 | 200.00 | 10,000.00 |
| 9 | An | F.v Shtiza me maje te zinkuara d=16 mm,L=0.5 ml | cope | 8.00 | 100.00 | 800.00 |
| 10 | An | F.V Kubike te gatshem betoni 40x40x40 | cope | 35.00 | 1,000.00 | 35,000.00 |
| **Shuma - IV** | | | | | | **177,300.00** |
| | | | | | | |
| **V** | ***Punime per MNZ*** | | | | | |
| 1 | an | F.V. Fikse zjarri me pluhur ,destinacioni per mbrojtje nga zjarri,kapaciteti 6 kg | cope | 4.00 | 5,200.00 | 20,800.00 |
| 2 | an | F.V. Fikse zjarri me CO2 ,destinacioni per mbrojtje e pajisjeve elektrike nga zjarri,kapaciteti 6 kg | cope | 2.00 | 5,500.00 | 11,000.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | an | Fv.Tabela Sinjalistike - Fikse zjarri me pluhur | cope | 4.00 | 1,100.00 | 4,400.00 |
| 4 | an | Fv.Tabela Sinjalistike - Fikse zjarri me CO2 | cope | 2.00 | 1,100.00 | 2,200.00 |
| 5 | an | F.v Tabela orientuese hyrje/dalje | cope | 6.00 | 450.00 | 2,700.00 |
| 6 | an | F.V. Dedektor tymi/temperature zjarri | cope | 57.00 | 3,700.00 | 210,900.00 |
| 7 | 2. a-139 | Ndricues evakuimi me llampe 1x11w,IP40 | cope | 6.00 | 4,700.00 | 28,200.00 |
| 8 | an | F.V Kutia e ndihmes se shpejte | cope | 1.00 | 4,700.00 | 4,700.00 |
| | | **Shuma - V** | | | | **284,900.00** |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| **VI** | ***Punime ngrohje*** | | | | | |
| 1 | an | Cmontim/montim kaldaje me te gjitha rakorderite perkatese | cope | 1.00 | 840,000.00 | 840,000.00 |
| 2 | an | Cmontim/montim radiatore | cope | 45.00 | 12,400.00 | 558,000.00 |
| 3 | 2.534 | Termoizolim tubo pambuk mineral, material termoizolues,rrjete, azbest, etj. | m2 | 14.10 | 1,800.00 | 25,380.00 |
| 4 | an | F.V Oxhak çeliku inoks/baker me dopio paret, me shtrese izioluese ne mes 300/350 mm,pajisur me te gjithe aksesoret | komplet | 1.00 | 144,000.00 | 144,000.00 |
| 5 | 2.494/2 | F.V saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm | cope | 4.00 | 1,450.00 | 5,800.00 |
| 6 | An | F.V Ajernxjerres Ø ½" | cope | 45.00 | 1,900.00 | 85,500.00 |
| 7 | An | F.V Elemente fiksues ne mur | cope | 90.00 | 250.00 | 22,500.00 |
| 8 | An | F.V Tub Cu te perkulshem me termoizolim Ø 14 x 1.0 mm, | ml | 45.00 | 2,000.00 | 90,000.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | UNI EN 1057 | | | | |
| 9 | 2.482/1 | F.V Kabell transmetimi ( 2 x 1.5 ) mm² | ml | 50.00 | 300.00 | 15,000.00 |
| 10 | An | F.V Rregullator klimatik elektroinik me mikroprocesor | cope | 1.00 | 14,000.00 | 14,000.00 |
| 11 | An | F.V Grupi I mbushjes automatike | komplet | 1.00 | 25,000.00 | 25,000.00 |
| 12 | 2.494/6 | F.V saracineska bronzi Ø63 | cope | 2.00 | 2,500.00 | 5,000.00 |
| 13 | An | F.V Kolektor shperndares per radiatoret Ø1" (9+9)x1/2" I kompletuar me valvula nderprerese ne hyrje-dalje, valvul balancuese, valvul zonale dy kalimshe, ajernxjerrese, valvula shkarkim, kuti montimi, dhe element te nevojshem montimi. | komplet | 2.0 | 25,000.00 | 50,000.00 |
| **Shuma - VI** | | | | | | **1,880,180.00** |
| | | | | | | |
| **SHUMA - I + II + III + IV+V+VI** | | | | | | **8,327,909.60** |
| ***TVSH 20 %*** | | | | | | **1,665,581.92** |
| **VII** | ***Paisje per ngrohje*** | | | | | |
| 1 | An | F. Element radiatori alumini per klasat , Presioni max. 600 kPa, interaksi 600 x 100 mm, ΔTek = 50ºC, Fuqia Termike 212 W. | cope | 360.00 | 2,700.00 | 972,000.00 |
| 2 | Analize | F.V Kaldaje çeliku (grup termik), lenda e djegeshme ashkla druri - capaciteti Q=120-150 kW =- lidhjet DN 40- 80 - dalja e oxhakut Ø 300-350 mm. me pompe antikondense te | cope | 1.0 | 290,000.00 | 290,000.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | inkorporuar, e pajisur me te gjithe komponentet e sigurise dhe kontrollit si dhe aksesoret e nevojshem. Karakteristikat Teknike: -Fuqia termike 120-150 Kw -Dimensionet e tubave dergim kthim :2 1/2". -Diametri i oxhakut te tymit Ø300-350 | | | | |
| 3 | An | F.V Termometer ( 0÷120°) | cope | 2.00 | 4,000.00 | 8,000.00 |
| 4 | An | F.V Manometer | cope | 2.00 | 3,300.00 | 6,600.00 |
| 5 | An | F.V Presostat sigurie | cope | 1.00 | 5,200.00 | 5,200.00 |
| 6 | An | F.V Flusostat | cope | 1.00 | 3,300.00 | 3,300.00 |
| 7 | An | F.V Sensor temperature | cope | 2.00 | 6,200.00 | 12,400.00 |
| 8 | An | F.V Sensor i temperatures se ambientit te jashtem | cope | 1.00 | 7,300.00 | 7,300.00 |
| 9 | An | F.V Pompe teke e kaldajes (Inverter) - prurja 20 m3/h; - prevalenca 50 kPa; - lidhjet DN 80, Pn 10; - fuqia elektrike 0.75 kW , rryma 2.9 A; - ushqimi 3F/230V/50Hz. | cope | 1.0 | 300,000.00 | 300,000.00 |
| 10 | An | F.V Ene zgjerimi me diafragme per linjat e terminaleve ngrohes: Volumi 50lit, Diametri 407 mm, Lartesia 530 mm, P.max 4 bar, T.punes -10÷99°C, Lidhja Ø3/4" | cope | 2.0 | 10,000.00 | 20,000.00 |
| | | | | | | |
| **Shuma - VII** | | | | | | **1,624,800.00** |
| | | | | | | |
| **SHUMA PER ZBATIM (I-VII)** | | | | | | **9,952,709.60** |

AVDULI SH.P.K

Tel/Fax: +355 42 246 - 367
Cel: +355 68 208 0387
E-mail: shpkavduli@yahoo.com

Lagjja: "10 Korriku
Rruga: "Perlat Rexhepi"
Objekt 3-katësh nr.4, Kati 1, Vlorë

**Nënshkrimi i ofertuesit : AVDULI shpk**

**Arben AVDULI- Administrator**

**Vula**




**Shënim:Çmimet duhet të shprehen në Monedhën LEK ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )**

III.1.8. Në kthimin e përgjigjes lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues autoriteti kontraktor argumenton se: *[...] Komisionii shqyrtimit të anksës gjithashtu u njoh me dokumentacionin e këtaj procedure prokurimi të hartar nga Njësia e Prokurimit e AK Bashkia Përmet dokumentacionin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, vlerësimin e bërë për këtë procedurë për ankimuesin, si dhe arsyet e skualifikimit të këtij operatori ekonomi. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) konstaton se pretendimet e*

*ankimuesit lidhen me:1. Ka mospërputhje në vlerën me TVSH midis shtojcës nr. 1 Formular Oferte me shtojcën nr. 2 Lista e Cmimeve sipas zërave të preventivit.*

*Në lidhje me këtë pikë duke parë formularin e ofertës (shtojca 1) dhe listën e cmimeve sipas zërave të preventivit (shtojca 2) të paraqitur nga OE në SPE ky oe nuk i është referuar preventivit të hartuar nga AK. Gjatë llogaritjes së preventivit zërit VII pajisje për ngrohje është pa TVSH. Në shtojcën nr. 1 ky oe vlerës totale pa TVSH i kashtuar përsëri TVSH. Komisioni Shqyrtimit të Ankesave pas shqyrtimit të ankesës dokumentacionit shoqërues të saj, dokumentacionit të dorëzuar në SPE dhe krahasuar me dokumentet standarte të tenderit konstaton se:*

*Vlera pa TVSH e preventivit total del nga pjestimi vlerës totale të objektit me TVSH (a+b) me shifrën 1.2 (njëpikë dy).*

*Ky gjykim në këtë rast është i gabuar pasi pajisjeve nuk u zbritet TVSH, pra ato kanë të njëjtën vlerë në të dy rastet si në ofertën pa TVSH edhe në ofertën me TVSH. Atëherë përsa përmendëm më sipër vlera totale e punimeve pa TVSH del nga mbledhja e punimeve ndërtimore dhe montimeve pa TVSH plus pajisjet, e pasqyruar në shifra: 8327909.6+1624800 =9952709.6.*

*Vlera e punimeve pa TVSH e shkruar në formular oferte 9952709.6 Vlera e punimeve me TVSH e shkruar në formular oferte është 11943251.5 Kjo ofertë është e gabuar tek vlera e punimeve me TVSH dhe ka një shtesë 324959.9 lekë quhet vlerë e gabuar.*

*Nëqoftëse ky gabim është më i madh se 2% e vlerës së ofertuar atëherë oferta është e pasaktë dhe përbën kriter skualifikimi (refuzuar). Vlera e ofertuar është 11943251.5x0.02=238865.03 324959.9 >238865.03*

*Mbështetur në nenin 82 pika 3 re VKM-së 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar Öferta me gabime aritmetike refuzohen kur shuma absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumëse 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofertuar prandaj me të drejtë KVO e ka refuzuar[...]*

III.1.9. Neni 2 "Qëllimi i ligjit" 162/2021 "*Për prokurimin publik"* parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.10. Neni 3 Parime të përgjithshme *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.11. Neni 77 "*Kërkesat për kualifikim*", të ligjit nr.162/2020 "*Për prokurimin publik*", parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*
*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

III.1.12. Neni 92 "*Shqyrtimi i ofertave*", të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", parashikohet shprehimisht se:
*1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*
*2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.*
*3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*
*Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.*

III.1.13. Neni 82 pika 3 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", e VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", parashikohet shprehimisht se:

*3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:*
*a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.*
*b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.*
*c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave "a" dhe "b", të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet.*
*Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:*
*- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;*
*- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.*

III.1.14. Ndërsa në nenin 92 pika 3 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", parashikohet shprehimisht se: *"3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..."*

III.1.15. Në Vendimin nr. 664, datë 26.9.2012 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"* ku është cituar se: "*1. Pika 1 të ndryshohet, si më poshtë vijon: "1. Unifikimin e metodologjisë së llogaritjes dhe të formatit të paraqitjes së preventivave, situacioneve dhe të analizave teknike të çmimeve me qëllim lehtësimin e veprimtarisë së subjekteve, që zhvillojnë veprimtari në fushën e ndërtimit, si dhe lehtësimin e kontrollit tekniko-financiar në këtë fushë".*

*2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon: 2. Hartimi i çdo preventivi apo situacioni në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimi e mbikëqyrja e çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen në përputhje me këtë vendim".*

III.1.16. Në Udhëzim Nr.1, Datë 16.6.2011 Për Disa Ndryshime Në Udhëzimin Nr.3, Datë 15.2.2001 Të Këshillit Të Ministrave "*Për Mbikëqyrjen Dhe Kolaudimin E Punimeve Të Ndërtimit*", të ndryshuar

*Preventivin e plotë të projektit të zbatimit, duke përfshire të gjitha vëllimet e punimeve të projekteve të lartpërmendura, hartuar nga projektuesit në përputhje me pikën 3.1 (formati tip bashkëlidhur këtij udhëzimi).*
*PROJEKTURSI: "____________________"*
*OBJEKTI: "___________________________"*
*Datë _____/_____/_______*

| *Nr.* | *Nr. Analizës* | *Emërtimi i punimeve* | *Njësia* | *Sasia* | *Çmimi* | *Vlera* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| *Shuma* | | | | | | |
| *TVSH* | | | | | | |
| *Shuma* | | | | | | |
| *Pajisje* | | | | | | |
| *Shuma* | | | | | | |

Preventivuesi                                        Investitori

_____________                                        ___________

III.1.12. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. *Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme*. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *"Për prokurimin publik"*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 "*Për prokurimin publik"* ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.13. Në rastin konkret, nga verifikimi i preventivit të paraqitur nga ankimuesi, konstatohet, se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij është bërë konform përcaktimit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, duke e shoqëruar këtë edhe me analizën e çmimeve përkatëse siç janë kërkuar në këto dokumente. Në dokumentet standarde të tenderit, është e përcaktuar në seksionin I Udhëzime për operatorët ekonomikë PËRGATITJA E OFERTAVE, pika 4. "*Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar*" ndërsa në pikën 6 "Çmimet" është përcaktuar se: "*Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës*". Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

III.1.14. KPP konstaton, se duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë për shkak se nevojiten njohuri të posaçme Komisioni, në një rast analog i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si institucioni i vetëm publik i cili në bazë ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore si Vendimi Nr. 514, datë 15.8.2007, "*Për Informatizimin e Llogaritjes së kostos dhe Hartimin e Manualeve Teknike të Cmimeve të Punimeve të Ndërtimit*" i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.1, Datë 16.6.2011 Për Disa Ndryshime Në Udhëzimin Nr.3, Datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave "*Për Mbikëqyrjen Dhe Kolaudimin E Punimeve Të Ndërtimit*", të ndryshuar, e cila me merret me hartimin e çdo preventivi apo situacioni në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimin e mbikëqyrjen e çdo punimi ndërtimi, si dhe me unifikimin e metodologjisë së llogaritjes dhe të formatit të paraqitjes së preventivave. Kështu, KPP, nëpërmjet shkresës 1325/5 prot, datë 15.08.2022 dhe shkresës nr. 1325/8 prot, datë 20.09.2022 i ka kërkuar këtij institucioni informacion/ekspertizë dhe interpretim për mënyrën e deklarimit të vlerës totale të ofertës pa TVSH në preventiv nga ana e autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë në rastet kur në preventiv përveç punëve ndërtimore parashikohen edhe furnizime pajisjesh. Nga korrespondenca me institucionin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në një rast analolog (këtu e në vijim M.I.E.) KPP konstaton, se me shkresën nr. 6124/3 prot., datë 29.09.2021, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1325/9 prot, datë 30.09.2022 me objekt: "*Kthim-përgjigje",* Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka dërguar informacion me përmbajtje si më poshtë vijon: *Hartimi i strukturave të preventivit kryhet në bazë të VKM nr. 514, datë 15.08.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve*

*teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"", të ndryshuar, UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, si dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit". Në UKM nr. 3 struktura e preventivit jepet në shtojcën bashkalidhur këtij udhëzimi dhe konkretisht:*

| *Nr.* | *Nr. Analizës* | *Emërtimi i punimeve* | *Njësia* | *Sasia* | *Cmimi* | *Vlera* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| *Shuma* | | | | | | |
| *TVSH* | | | | | | |
| *Shuma* | | | | | | |
| *Pajisje* | | | | | | |
| *Shuma* | | | | | | |

*Për sa paraqitëm më lart punimet e ndërtimit dhe ato teknologjike dhe të montimit janë pjesë e shpenzimeve të drejtëpërdrejta të cilave ju shtohet vlera e TVSH-së në fund të preventivit, ndërsa vlera e pajisjeve vendoset në fund të preventivit pas vlerës së TVSH-së.*

Nga sa më sipër pasqyruam rezulton, se preventivi i paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ankimues është në përputhje me të gjithë zërat e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, "Në rubrikën dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion të operatorëve ekonomikë dokumentin me emërtimin: 1. Preventiv pa çmime. Formati i vënë në dispozicion është përdorur nga operatori ekonomik ankimues për plotësimin e ofertës ekonomike". Referuar preventivit të hartuar nga vetë autoriteti kontraktor, KPP konstaton se punimet e kërkuara janë kategorizuar nga ana e autoritetit kontraktor në Punime Ndërtimi dhe montime, si edhe furnizim pajisje . Komisioni konstaton, se hartimi i strukturës së preventivit për këtë objekt-prokurimi nga ana e AK dhe plotësimi i preventivit nga ana e OE referuar dhe kthim-përgjigjes së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është konform dispozitave ligjore të fushës së ndërtimit (Vendim Nr. 664, datë 26.9.2012 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit" si dhe Udhëzim Nr.1, Datë 16.6.2011 Për Disa Ndryshime Në Udhëzimin Nr.3, Datë 15.2.2001 Të Këshillit Të Ministrave "Për Mbikëqyrjen Dhe Kolaudimin E Punimeve Të Ndërtimit", të ndryshuar), dhe nuk ka krijuar asnjë konfuzion në mënyrën e plotësimit të tij nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues. Gjithashtu, edhe nga përcaktimet e bëra në shtojcën 1 nga ana autoritetit kontraktor nuk konstatojmë se ka paqartësi ç'ka mund të ndikonte tek operatorët ekonomikë gjatë plotësimit të kësaj shtojce. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i formularit të ofertës, preventivit dhe

parashtrimeve me shkrim të ankimuesit dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ndodhemi në kushtet e mospërputhjes së shumës së ofertës ME TVSH të pasqyruar në formularin e ofertës, me përllogaritjen e shumave të pasqyruara në preventivin përkatës, përkatësisht Shuma I+II+III+IV+V+VI *"Punime"* (I+II+III+IV+V+VI + shuma *VII Pajisje për ngrohje")* te ofruar në preventiv me ato të ofruara në formularin e ofertës. Mospërputhja vjen si rrjedhojë e përllogaritjes së Shumës I+II+III+IV+V+VI "Punime" + shumën e TVSH-së për I+II+III+VI+V +VI + Shumën Totale "Pajisje" dhe totalin e të gjithë zërave të shumëzuar me (1.2). Pra operatori ekonomik ankimues ofertën me TVSH të deklaruar në formularin e ofertës nuk e ka deklaruar sipas shumës në preventiv, pasi sipas përllogaritjes së shumave në tabelën përmbledhëse të preventivit oferta totale me TVSH e deklaruar në formularin e ofertës duhet të ishte Shuma I+II+III+IV+V+VI "Punime"+ TVSH për këto zëra të ofruar në preventiv + Shumën Totale të zërit VII "*Pajisje*". Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues ndodhet në kushtet e përllogaritjes së ofertës ekonomike në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në mënyrë jotransparente, pasi referuar formularit tip të përcaktuar në Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, dhe oferta ekonomike me TVSH duhet të ishte përllogaritur si më poshtë vijon:

| Nr. | Nr. i analizës | Emërtimi i punimeve | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlefta |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | Shuma | | | | |
| | | TVSH | | | | |
| | | Shuma | | | | |
| | | Pajisje | | | | |
| | | Shuma | | | | |

Referuar formularit të ofertës, nga ana e operatorit ekonomik ankimues vlera e ofertës pa TVSh është deklaruar vlera prej 9,952,709.6 lekë pa TVSH (vlerë e cila përfshin edhe Pajisjet vlerën e të cilave e ka shumëzuar me 1.2), pra vlera punimeve ndërtimore me TVSh = 8327909.6 + tvsh e këtyre punimeve 1665581.92 + Pajisjet e shumëzuara me 1.2 ndërsa si vlerë të ofertës me TVSH është deklaruar vlera prej 11943251.5 lekë me TVSH. Pra referuar sa më sipër cituar, operatori ekonomik ankimues në preventiv ka deklaruar vlerën e Pajisjeve (shuma VII) në shumën (1624800). Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 "*Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave "*Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH*" dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*", të ndryshuar, pasi vlera ofertës me TVSh duhej përllogaritur SHUMA I+II+III+IV+V+VI pa TVSh + tvsh e këtyre zërave

I+II+III+IV+V+VI, që sipas vlerave të preventivit të paraqitur 8327909.60 + 1665581.92 dhe duke shtuar vlerën e shumës VII pajisje në vlerën 1624800. Në rastin konkret KPP gjykon, se si autoriteti kontraktor ashtu edhe operatori ekonomik ankimues shfaqet në cilësinë e tatimpaguesit të cilët në transaksionet financiare midis tyre zbatojnë lex specialis, ligjin në fuqi për procedurat tatimore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar. Gjithashtu, referuar preventivit të sipërcituar, si edhe mbi thelbin e pretendimeve të autoritetit kontraktor, shfaqet i nevojshëm interpretimi mbi mënyrën e rregullimit të transaksionit në fushën e zbatimit të TVSH-së në cilësinë e furnizimit të mallit ose furnizim shërbimi, i kryer kundrejt pagesës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë, në kuptimin që ligjit. Për një interpretim të drejtë, KPP gjykon t'i drejtohet rregullimit ligjor, lex specialis ligjit nr. 92/2014 "*Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave "*Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH*". Konrketisht, referuar pikës 3 "Modalitetet dhe mënyra e zbatimit të TVSH-së në ndërtim" të Udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH", KPP gjykon, se për sa kohë që pajisjet e mësipërme të parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor ofertohen me vlerën e tyre të plotë përfshirë vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, atëherë në ofertën ekonomike përfundimtare (totale), vlera totale e tyre, e paisjeve (bashkë me TVSH) duhet të shtohen në përfundim të totalit të propozuar të ofertës ekonomike pa TVSH. Gjithashtu edhe në dokumentet standarde të tenderit Seksioni I "*Udhëzime për operatorët ekonomikë*", përcaktohet se: *Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar zërat e punimeve që do të realizohen, sasitë dhe çmimin e tyre në rastin kur në kohën e ofertimit është e mundur (ka një projekt-preventiv mbi bazën e të cilit të do realizohen punimet). Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.*

III.1.15. Megjithatë, në rastin konkret, për një shqyrtim të drejtë të pretendimit të operatorit ekonomik ankimues nga njëra anë, si edhe parashtrimeve të autoritetit kontraktor nga ana tjetër, KPP gjykon të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve të sipërcituara, mbi gabime të mundshme në përllogaritjen e ofertës ekonomike si vlerë totale e kërkuar, pa shtuar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar për kryerjen e punimeve në total. Referuar tabelës përmbledhëse të formularit të ofertës, KPP konstaton, se punimet e kërkuara janë kategorizuar nga ana e autoritetit kontraktor në Punime prishje, Punime termoizolimi, suvatimi, shtesash etj, Punime hidroizolimi,taracë, lyerje+etj Sistemimi i mbrotjes dhe shkarkimet atmosferike dhe tokëzimi, Punime MNZ, Punime Ngrohje, si edhe furnizim i pajisjeve me TVSH. Në pikën 3 "Modalitetet dhe mënyra e zbatimit të TVSH-së në ndërtim të Udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 "*Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH*", paragrafët 1,4 parashikohet se "*Kur një person i tatueshëm, shoqëri ndërtimi kryen punime ndërtimi të çdo lloji për punë private ose publike, punime në të cilat përveç vlerës së punës përfshihet edhe vlera e materialeve të përdorura, punime rikonstruksioni, restaurimi të një objekti ose ndërton një objekt (ndërtesë) të re, ose kryen punime që kanë të bëjnë me punë publike (rrugë, rregullim terrenesh, etj.), është i detyruar që çdo muaj të situacionojë punimet e kryera nëpërmjet një situacioni*

*analitik ku të tregojë të gjitha zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura në sasi e vlerë dhe çdo element tjetër punimesh të përfshirë në situacionin e punimeve, përfshirë edhe tatimet apo taksat apo detyrime të tjera që llogariten dhe përfshihen në vlerën e tatueshme të punimeve të kryera, përveç TVSH-së.*
*Bazuar në nenin 99, pika 5 të ligjit fatura në ndërtim lëshohet çdo muaj. Çdo situacioni mujor të punimeve të kryera i bashkëngjitet detyrimisht fatura tatimore me numër serial. TVSH-ja llogaritet dhe paguhet çdo muaj mbi vlerën e situacionit mujor të punimeve, e cila është edhe vlera e tatueshme mbi të cilën do të llogaritet TVSH- ja në masën 20%. Gjithashtu çdo person i tatueshëm që kryen punime të pjesshme në ndërtimin e një objekti si p.sh. punimet elektrike të objektit është i detyruar të tregojë në faturë zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura dhe vlerat përkatëse për çdo zë më vete. Vlera e çdo situacioni mujor të shoqëruar me faturën tatimore me TVSH regjistrohet në librin e shitjeve dhe deklarohet në deklaratën e TVSH-së të periudhës që i përket*
*4. Në rastin kur ndërtohet një objekt prej një personi të tatueshëm që ndërton sipas porosisë së një personi tjetër të tatueshëm, një objekt për qëllime të kryerjes së veprimtarisë ekonomike së tij ekonomike, mund të ndeshemi me dy situata:*
*a) Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm;*
*b) Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të tatueshme të personit të tatueshëm.*

*Për sa i përket pikës 4, rasti a), ku objekti që ndërtohet do t'i shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm. Për shembull ndërtohet një bankë, ose një shkollë, ose një spital, atëherë: Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore personit të tatueshëm investitor të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH-në, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana e tij, personit të tatueshëm investitor të objektit, i cili do ta përdorë objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të përjashtuar nga TVSH-ja, bazuar në rregullat e zbritshmërisë së TVSH-së të parashikuara në kapitullin X të ligjit, nuk i lind e drejta të zbresë TVSH-në e paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim, këto punime të kryera bazuar edhe në parimin e neutralitetit të TVSH-së do të përdoren dhe do t'i shërbejnë një veprimtarie, nga e cila nuk lindin pagesa të TVSH-së, për sa kemi të bëjmë me veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit.*
*Për sa i përket pikës 4, rasti b), ku objekti që ndërtohet do t'i shërbejë veprimtarisë ekonomike të tatueshme të personit të tatueshëm, për shembull ndërtohet një magazinë që personi i tatueshëm 12 e përdor për magazinimin e mallrave për t'u shitur, atëherë: Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore personit të tatueshëm investitor të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana e tij, personit të tatueshëm investitor të objektit, i cili do ta përdorë objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të tatueshme, bazuar në rregullat e zbritshmërisë së TVSH-së të parashikuara në kapitullin X të ligjit, i lind e drejta e zbritjes së TVSH-në së paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim do të përdoret për një veprimtari të tatueshme me TVSH, për pasojë bazuar në parimin e neutralitetit të TVSH-së do t'i shërbejë një veprimtarie nga e*

*cila lindin pagesa të TVSH-së".* Në rastin konkret, KPP gjykon, se në përllogaritjen e vlerës ekonomike operatori ekonomik ankimues ka parashikuar vlerën totale të punimeve pa TVSH dhe vlerën totale të punimeve me TVSH. Për sa kohë që pajisjet e mësipërme të parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor ofertohen me vlerën e tyre të plotë përfshirë vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, atëherë në ofertën ekonomike përfundimtare (totale), vlera totale e tyre e pajisjeve (bashkë me TVSH) do të shtohen në përfundim të totalit të propozuar të ofertës ekonomike me TVSH. Sa më sipër, KPP gjykon, se në përllogaritjen e vlerës totale të ofertës ekonomike me TVSH në rastin e sipërcituar, ku krahas ndërtimit/rikonstruksionit ka edhe pajisje, vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH do të jetë vlera e punimeve të kërkuara pa TVSH, shtuar vlerën e pajisjeve (të cilat ofertohen së bashku me TVSH) ndërsa vlera totale e ofertës ekonomike me TVSH, përfshin njëherazi edhe 20% e vlerës pa TVSH të punimeve. Vlera e korrigjuar e ofertës ekonomike pa TVSH konstatuar nga ana e autoritetit kontraktor konstaton në kryerjen e veprimeve aritmetike te zbritjes nga oferta totale te Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, çka rrjedhimisht sjell zbritjen njëherazi edhe të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar të pajisjeve, të cilat, referuar UMF ofertohen në vlerë totale vetëm me TVSH dhe në përllogaritjen e ofertës nuk i nënshtrohen dy herë llojit të tatimit, tatimit mbi vlerën e shtuar. Akoma më tej, vetë fatura tatimore e lëshuar nga ofertuesi në cilësinë e personit të tatueshëm investitor përmban dy kolona, atë të vlerës pa TVSh dhe Vlerën e TVSH-së. Vlera e TVSH-së e paisjeve është përfshirë një herë në ofertën ekonomike dhe nuk mund të tatohet dy herë në kryerjen e veprimeve financiare. Komisioni gjykon, se përllogaritja duke tatuar dy herë në total me Tatimin mbi Vlerën e Shtuar zërin e pajisjeve dhe më pas llogaritjen e TVSh-së përsëri në ofertën totale me TVSh, shkakton një ofertë ekonomike pa TVSh joreale. KPP gjykon, se në cilësinë e personit të tatueshëm ndërtues, operatori ekonomik ankimues nuk e ka përllogaritur koston ekonomike të ofertës së tij duke përfshirë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi dhe veçanërisht detyrimet dhe rregullimet e kreditimit/zbritjes së tatimit mbi vlerën e shtuar. Në këto kushte, KPP gjykon, se vlera e ofertës ekonomike me TVSH e paraqitur nga ankimuesi, e cila është përllogaritur duke bërë tatuar dy herë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar të pajisjeve, të cilat, referuar UMF ofertohen në vlerë totale vetëm me TVSH, është në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të sipërcituara. Në këto kushte, KPP gjykon, se mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përllogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim, për këtë arsye vendimi i KVO-së për refuzimin e ofertës të operatorit ekonomik ankimues "Avduli" shpk është i drejtë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Avduli" SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe operatori ekonomik ankimues "Avduli" SHPK nuk përmbush kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në DT dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk

ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *"Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik",* Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "Avduli" SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur e thjeshtuar" me Nr. REF-44556-10-05-2022, me objekt "Termoizolimi dhe përmirësimi i sistemit të ngrohjes i Konviktit Përmet" me fond limit 11 507 560 (njëmbëdhjetë milion e peseqind e shtatë mijë e peseqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH., zhvilluar në datën 17.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Përmet.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Avduli" SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**
**Fiorent Zguro**

Digitally signed by
Fiorent ZGURO
Date: 2022.12.12
04:08:38

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2022/12/12 15:52:59 +02'00'
1111822022121215524970020



*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)*